



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:231063

Datë: 23.02.2023

Numri i dokumentit: 04006629

PKR.nr.154/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti për Krime të Rënda - trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët: Islam Thaçi, kryetar, Agim AD dhe Ramiz Azizi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore- procesmbajtëses Zahide Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarëve: B.H dhe B.A, për shkak të veprës penale në bashkëveprim, trafikim me njerëz nga neni 165 paragrafi 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të cilët sipas autorizimit i mbrojnë edhe atë: për B.H...av.Jeton Ibrahimimi nga Gjilani, si dhe për B.A av.Masar Morina nga Gjilani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.178/2021 të datës 12.11.2021, të cilën e përfaqëson Prokurori i Shtetit, Isuf Sadiku, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publike me datë 25.01.2023, në prani të palëve me datë 30.01.2023, shpalli publikisht, ndërsa me datë 20.02.2023, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.B.H... nga babai B... dhe e ëma S..., e lindur Sh, i lindur më 1..., në G..., me vendbanim "K.D", rruga "Sh.M", numër , Gj..., me numër personal 1....., me numër të tel 045....., ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar deri më tani Taksist, i martuar, baba i një fëmije, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.B.A...., nga babai Sh... dhe e ëma M..., e lindur M..., i lindur më 0., në Gj..., me vendbanim rruga "Gj.S", nr.1, në Gj., me numër personal 1.....me numër të tel 045....., ka të kryer shkollën e mesme, drejtimi i mjekësisë, i papunësuar, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike- shfrytëzues i ndihmave sociale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË F A J T O R Ë

Sepse:

I pandehuri B.H dhe B.A, gjatë vitit 2021, të pandehurit e lartshënuar në bashkëveprim në dy lokacione të ndryshme në motel "A..." në fshatin D., Komuna R.. dhe në kafiterin ish "A.." fshati D., Komuna e Gj..., e kanë trafikuar për qëllime të shfrytëzimit seksual dëmtuarën A.H nga fshati D., Komuna e I..., duke e ditur gjendjen e saj të rëndë ekonomike-sociale, në atë mënyrë që, e njëjta të ofroj shërbime seksuale me pagesë personave të ndryshëm, kur i pandehur B... fillimisht e kishte thirrur në telefon viktimën dhe më pas e kishte dërguar viktimën në një kafiteri "(ish A.) në fshatin D..., Komuna e Gj..., ku ishte takuar me të pandehurin B..., i cili i kishte paguar kinse shërbimet për taksi në vlerë 31€, dhe

më pas i pandehuri B.. dhe i pandehuri H... sipas dispozitivit II, shkojnë me viktimën e motelit të lartpërmendur në fshatin D., Komuna e R..., dhe derisa viktimja kishte shkuar të kryej marrëdhënie seksuale pa dëshirën e saj, dhe pas reagimit të viktimës, i pandehuri B... ia jep viktimës 20€.

Me çka në bashkëveprime kanë kryer veprën penale, trafikimi me njerëz nga neni 165 paragrafi 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e sipër theksuara ligjore si dhe neneve: 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71, dhe 72 të KPRK-së, si dhe nenit 364 dhe 452 të KPPRK-së, të akuzuarit, i

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 3 (tre) vite, të cilat dënime do ti mbajnë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, dhe dënim me gjobë në shumën prej nga 300€ (treqind) Euro, të cilat do t'i paguajnë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në dënimin e shqiptuar me burgim, të akuzuarve: B.H dhe B.A do të i'u llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 14.10.2021 deri në 04.03.2022.

Mirëpo, nëse të akuzuarit nuk mundën apo nuk dëshirojnë që të paguajnë dënimin me gjobë në shumën si më lart, atëherë gjykata dënimin me gjobë do t'i u zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20€ (njëzet) Euro të dënimin me gjobë do t'i u llogaritet me nga 1 (një) ditë burgim.

Detyrohen të akuzuarit, secili prej tyre veç e veç që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale, përkatësisht paushallin gjyqësor në shumën prej nga 100€ (njëqind) Euro, si dhe taksat në shumën prej nga 50€ (pesëdhjetë) Euro për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

E dëmtuara A.H, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A R S Y E T I M

1.Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan- Departamenti për Krime të Rënda në këtë gjykatë me datën 12.11.2021, ka paraqitur aktakuzën PP.I.nr.178/2021, kundër të akuzuarve: B.H dhe B.A për veprën penale të kryer në bashkëveprim, trafikimi me njerëz nga neni 165 paragrafi 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe kundër të akuzuarit H.B... për veprën penale, shërbimet seksuale të viktimës të viktimës së trafikimit nga neni 228 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.187/2021 të datës 22.04.2022, ka shpallur fajtorë të akuzuarit dhe i ka gjykuar si në vijim: B.H, për veprën penale dispozitivi I i aktakuzës, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3

viteve dhe dënim me gjobë në shumën prej 500€, të akuzuarin B. Apër veprën penale dispozitivi I i aktakuzës, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 viteve dhe dënim me gjobë në shumën prej 300€, si dhe të akuzuarin H.B, për veprën penale dispozitivi II i aktakuzës, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditëve, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej 3500€.

Në dënimet e shqiptuara të akuzuarve i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 14.10.2021 deri në 04.03.2022.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me aktgjykimin PAKR.nr.292/2022 të datës 20.07.2022, ka aprovuar ankesën e mbrojtësit së të akuzuarit B.H, av.Jeton Ibrahim, dhe ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.187/2021 të datës 22.04.2022, sa i përket pikës I të dispozitivit për të akuzuarit B.H dhe B.A, dhe çështja për këtë pikë i është kthyer të njëjtës gjykatë në rigjykim, ndërsa sa i përket ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, në raport me të akuzuarin H.B, për pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar, dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.187/2021 të datës 22.04.2022, e ka vërtetuar.

Gjykata, ka mbajtur seancat e shqyrtimeve gjyqësore me datat: 23.09.2022, 06.12.2022 dhe 25.01.2023, në të cilat kanë prezantuar Prokurori i Shtetit, Isuf Sadiku, të akuzuarit: B.H me mbrojtësin av.Jeton Ibrahim, B.A..me mbrojtësin av.Masar Morina dhe sipas autorizimit zëvendësues av.Avdullah Ismajli, përfaqësuesi i mbrojtës së Viktimave Driton Hashani, e dëmtuara A.H, si dhe dëshmitari S.Z.

Kryetari i trupit gjykues në seancën e parë të shqyrtimit gjyqësor i ka njoftuar të akuzuarit me të drejtat e tyre në kuptim të nenit 323 të KPRK-së, pastaj Prokurori i Shtetit, të akuzuarve iu ka lexuar aktakuzën, e meqë të njëjtit kanë deklaruar se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohen, dhe që pas pyetjes së kryetarit të trupit gjykues se a e pranoni fajësinë për veprën penale të përshkruara si në dispozitivin I aktakuzës, të akuzuarit B.H dhe B.A kanë deklaruar: se nuk e pranojnë fajësinë për veprën penale dispozitivi I i aktakuzës, me arsyetimin se të njëjtën nuk e kanë kryer.

Meqenëse të akuzuarit: B.H dhe B.A, nuk e kanë pranuar fajësinë për veprën penale dispozitivi I i aktakuzës, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalët hyrëse të palëve.

Prokurori i Shtetit, ka mbetur në tërësi pran pretendimeve të përshkruara si në dispozitivin I të aktakuzës sa i përket të akuzuarve: B.H dhe B.A, duke konsideruar se organi i akuzës ka prova të mjaftueshme dhe bindëse për të vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, duke i propozuar gjykatës që të vazhdohet me procedurën e provave.

Përfaqësuesi i Zyrës për Mbrojtjen e Viktimave, Driton Hashani ka deklaruar: e mbështes fjalën hyrëse të Prokurorit të Shtetit.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.H av. Jeton Ibrahim ka deklaruar: se me ngritjen e aktakuzës si dhe provat të cilat janë bashkangjitur aktakuzës deri më tani nuk është vërtetuar asnjë veprim inkriminues gjegjësisht fajësues që shkon në drejtim të mbrojtësve tjerë për faktin se kjo

aktakuzë është e bazuar vetëm në deklaratën e viktimës e të cilat deklarata janë kontradiktore dhe të paqëndrueshme, andaj, mbrojtja konsideron se nuk janë përmbush elementet e veprës penale dhe se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë, që i mbrojturi im ta ketë kryer veprën penale, e që gjendja faktike pas administrimit do të vërtetohet se i mbrojturi im nuk e kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari B.H ka deklaruar: e mbështes fjalën hyrëse të mbrojtësit tim.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.A, av. Avdullah Ismajli ka deklaruar: duke pasur parasysh faktin se i mbrojturi im B.A, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 01.03.2022 e ka pranuar fajësinë, ndërsa tani pasi që lënda është kthyer në rigjykim, i njëjti nuk e pranon fajësinë, andaj edhe unë në cilësinë e mbrojtësit e mbështes mospranimin e të akuzuarit në fjalë, dhe pajtohem që seanca të vazhdoj me procedurën e provave.

I akuzuari B.Aka deklaruar: e mbështes fjalën hyrëse të mbrojtësit tim.

Pas fjalëve hyrëse të palëve, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me procedurën e provave.

2.Provat e admistruara

Gjykata gjatë shqyrtimeve gjyqësore ka administruar provat material si në vijim: deklaratën e të dëmtuarës në cilësinë e dëshmitares A.H, deklaratën e dëshmitarit S.Z, raporti fillestar i incidentit i datës 05.11.2021, si dhe mbrojtja përkatësisht deklaratat e të akuzuarve: B.H dhe B.A.

E dëmtuara në cilësi të dëshmitares A.H ka deklaruar: unë lidhur me këtë rast kam dhënë deklaratë në polici dhe prokurori, andaj mbetem në tërësi pranë të njëjtave. Ditën kritike kur B.H më ka dërguar me automjetin Taksi, prej Gjilanit te lokali “A..” në fshatin D., B.Aia ka dhënë 6 euro B.H, këto para B.. ia ka dhënë për shpenzime të transportit për çka më ka dërguar te lokali në fjalë, ndërsa 20 euro, po ashtu B... mi ka dhënë vullnetarisht me ia dërgua fëmijëve, edhe atë pasi që H.B e ka kryer marrëdhënien seksuale me mua.

Në ballafaqimin e PSH, me deklaratën e të dëmtuarës-dëshmitares të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, me datë 01.03.2022, faqja 7, rreshti i tret nga fundi ku keni deklaruar: ”Unë e kam parë B... duke ia dhënë paret B.H, edhe atë nga 30- 40 euro, edhe atë për 3- 4 herë sa kemi dal me B....”

Dëshmitarja deklaroi: sa herë që jam takuar me B.A, i njëjti ja ka dhënë nga 30- 40 euro B....., mua nuk më kujtohet sa herë kam dalë me B....., por ndoshta 3-4 herë, kështu që sa herë kam dalë me B..., ai nga 30- 40 euro ia ka dhënë B.... Unë nuk e di se pse Be..., ia ka dhënë Bu..., por vet B... më ka pyetur se pse unë duhet me ja dhënë këto para B....., unë atij i kam thënë se nuk e di se çka keni përzier ju në mes veti.

Në pyetjen e PSh se këto 30- 40 euro, të cilat B.. ia ka dhënë B..., edhe atë për 3- 4 herë që kam dal me të, se a kanë qenë shërbime të taksit apo diçka tjetër, dëshmitarja deklaroi: jo, nuk është e mundur që këto para B... t’ ia ketë dhënë B..... për shpenzimet e taksit, sepse nga Gj.... kur më ka dërguar deri te B.... ku ka qenë në lokal duke punuar, shërbimet janë 4-5 euro.

Po ashtu dëshiroj të deklaroj se çdo herë kur B....., kur më ka dërguar te B... në lokalin e tij, i cili ka qenë lloj podrumi, unë nuk kam mundur të hy brenda, derisa të ketë dalë B... dhe t’ ia ketë dhënë paratë B..... Unë asnjëherë B... nuk i kam parashtruar pyetje se pse po i merr këto para B....., sepse unë me B.... kemi qenë koleg të punës, e po ashtu edhe këta në mes veti kanë qenë shokë. Paratë të cilat i ka marr B.... prej Be... nuk ka ndodh asnjëherë të mi jap edhe mua.

Në pyetjen e përfaqësuesit të ZMNV-s, Driton Hashanaj, e dëmtuara deklaroi: para se me u njohur unë me Be..., Bu... nuk më ka dhënë mua para, por ju ka blerë fëmijëve gjëra ushqimore.

Në pyetjen e mbrojtësit, av. Jeton Ibrahimimi, e dëmtuara-dëshmitarja deklaroi: unë me Bu... më parë nuk kemi pasur asnjë problem, përveç këtij rasti, dhe një herë për armë. Mua nuk më kujtohen datat dhe orët kur kam shkuar te B..., por e di se ka qenë mbrëmje. Nga momenti që jam njoftuar me B..., unë me të kam pasur raporte të mira, dhe prej se më ka ndodh rasti me H.B, nuk kam pasur kontakt me të. Unë marrëdhëniet seksuale me Be... i kam bërë me dëshirë. Kur më ka ftuar Be... me shkua tek ai, nuk kam mundur me shkua me dikë tjetër, për shkak se Be... ka pasur kontakt me Bu..... Kjo ka ndodhur për faktin se për herë të parë Bu..... më ka njoftuar me B..., edhe atë herën e parë kur jam takuar live me B., B... më ka dërguar tek ai. E dëmtuara deklaroi se unë nuk kam pasur kërcënim nga B.. me më dërgua te B.... Natën kritike kur B.. mi ka dhënë 20 euro me ia dërgua fëmijëve, unë prej D... edhe atë, pasi që H.. ka kryer marrëdhënie seksuale me mua, B... ka provuar me pas marrëdhënie seksuale me mua, unë nuk kam dashur, e pastaj me H.. kemi ardhur në Gjilan. Kur më ka dërgua B... te B..., ai mua nuk më ka prit, por kur e kam kryer punën me B..., ai ka ardhur dhe më ka marr.

Në pyetjen e të akuzuarit B.H, e dëmtuara- deklaroi: Unë ty po të akuzoj për veprën penale për të cilën ma ke bërë, edhe atë për faktin se shoku yt B... më ka thënë se pse unë duhet me i dhënë para B....

Në pyetjen e av. Abdullah Ismajli, e dëmtuara deklaroi: unë kur kam shkuar në lokalin që gjendet në D..., marrëdhënie kam pasur vetëm me H..., ndërsa atë natë nuk kam pasur marrëdhënie me B... pasi unë me të kam qenë në lidhje.

Në pyetjen e të akuzuarit B.A, e dëmtuara- deklaroi: ditën kritike kur unë kam ardhur te "A...." në fshatin D..., ju e keni thirrë B..., ndërsa B... më ka thirrë mua dhe më ka thënë se po të thirr B... në D.... Është e vërtetë se unë në lokalin e fshatit D..., kam pasur marrëdhënie seksuale me H.B, ndërsa ti ke shkuar me marrë pije dhe më ke thënë se pas 5 minutave vi, dhe aty ka ardhur H.B, kështu që unë kam qenë e stresuar dhe nuk kam pas dëshirë me pas marrëdhënie me ty. Është e vërtetë se kur më keni sjellë me H.B në Gj..., ti mi ke dhënë 20 euro dhe më ke thënë bliju fëmijëve diçka. Unë me ty jam takuar 3- 4 herë në rrugën e M.... në lokalin ku ke qenë ti duke punuar, ndërsa takimin e fundit me ty e kam pasur në fshatin D....

Në pyetjet e anëtarëve të trupit gjykues, e dëmtuara-dëshmitarja deklaroi: me B... i kam prish raportet në momentin kur ka ndodhur rasti me H.B në fshatin D..., e që nga atëherë unë nuk kam pasur marrëdhënie seksuale me B.... Arsyeja se pse jam prish me B... ka qenë se ky ma shti personin në dhomë pa e njohur kurrë, e po ashtu edhe me B... kam pasur raporte të mira, derisa ka ndodhur një rast tjetër që akuzohem për armë.

Pasi që ka ndodhur ky rast në D..., e më konkretisht nga momenti që jam ftuar në polici për trafikim, unë nuk kam pasur asnjë kontakt me ta. Prej Gj... në D... me taksit me ka dërguar B..., dhe prej aty e në D..., më kanë dërguar H.... me B. me automjetin Gollf III, i cili ka qenë i H., e nga D. me të njëjtin jam kthyer në Gjilan te banesa ime. B. mua nuk më ka kërkuar para. Unë personalisht e kam vërejtur 3- 4 herë Bn duke i dhënë para B... kur më ka dërguar tek ai në lokal rrugës së M..., edhe atë një 20 –she apo dy 10-she, por kështu ka ndodhur 3-4 herë që kam shkuar te B., megjithatë unë nuk e di arsyen se pse ja ka dhënë këto para dhe nuk e kam

vet asnjëherë B... pse po jep para B.... Unë me të akuzuarin B.A, asnjëherë nuk kam pasur marrëdhënie seksuale në D... tek A....

Në pyetjen e av. Jeton Ibrahim, e dëmtuara deklaroi: me B unë asnjëherë nuk kam pasur marrëdhënie seksuale.

Në pyetjen e serishme të përfaqësuesit të ZMNV-ës, e dëmtuara-dëshmitarja deklaroi: gjatë kohës sa kanë qenë në parburgim B... dhe B..., unë me një anëtarë të familjes së B..., kam pasur një takim edhe atë me bashkëshorten e B..., derisa unë kam qenë me një kafiteri në Gjilan, kushëriri i B.. ka ardhur te un, aty ku isha ulur dhe më ka thënë se bashkëshortja e B..., Xh..., po dëshiron me ma bë një pyetje, kështu që ka ardhur te unë me ka thënë, se po ta jap një shtëpi me qëndrua 2 vjet falas dhe po të jap para për me mbijetua, edhe atë me qëllim që unë ta mbroj B..., me fjalë të tjera, krejt fajin e B..., me ja lënë B... dhe H.... Unë nuk kam pranuar dhe kam deklaruar si më parë dhe i kam thënë se për këtë vendos gjykata.

Në pyetjen e av. Jeton Ibrahim, e dëmtuara deklaroi: Unë këtë rast nuk e kam paraqit në polici, për faktin se këta të sipër theksuarit vetëm më kanë ofruar para dhe shtëpi për banim falas, ndërsa unë nuk e kam ndier veten të kanosur.

Në pyetjen e av. Abdullah Ismajli, e dëmtuara- dëshmitarja deklaroi: ne me Bn kemi shkëmbyer sms, me mesëngjer edhe atë para se me i prish raportet.

Në pyetjen e serishme të akuzuarit B.A, e dëmtuara – dëshmitarja deklaroi: Po ashtu edhe para se me u taku në këtë lokal me bashkëshorten tuaj, jemi takuar edhe më parë, sepse ajo paraprakisht më ka shkruar në viber, dhe më ka thënë se po dua me të takua, ngase kam dëgjua se je nënë e dy fëmijëve dhe po dua me të ndihmua. Unë asaj i kam tregu, ajo ka ardhur te banesa ime dhe jemi takuar në katin e parë. Posa ka ardhur aty, ajo mua më ka thënë se qysh ti je në lidhje me burrin tim, e që unë nuk e kam ditur se është i martuar dhe atë e ka grua, kemi biseduar me të, dhe gjatë asaj kohe ajo ka biseduar me B...., por ka qenë shumë nervoz. Unë nuk e di se ku e ka gjet ajo numrin tim.

Në pyetjet e PSH, dëshmitari S.Z ka deklaruar: lidhur me rastin në fjalë, unë kam qenë hetues i rastit, kështu që unë e kam hartuar kallëzimin penal, si dhe të gjitha shkresat që i janë bashkangjitur këtij kallëzimi, po ashtu është e vërtetë se lidhur me këtë rast unë kam deklaruar në seancën e kaluar në këtë gjykatë me datën 28.03.2022 dhe mbetem në tërësi pranë deklaratës së dhënë. Edhe sa i përket Bt lidhur me këtë rast, i njëjti ka deklaruar se ka qenë i përfshirë dhe se vet e ka pranuar faktin se ka pasur marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën A.H, dhe është edhe një fakt tjetër se për të dëmtuarën ka qenë ndërmjetësues për shfrytëzimin e saj edhe atë me H.B.

Në bazë të deklaratës së të dëmtuarës A.H, edhe atë B.A, H.B dhe B.H, këta kanë komunikua në mes veti dhe B ka komunikuar me B, kështu që e ka ndërmjetësua viktimën që H.B...që të kryej marrëdhënie seksuale me pagesë me të dëmtuarën A.H. Me sa më kujtohet e dëmtuara nuk e ka njohur H.B para se me pas marrëdhënie seksuale me të njëjtin. Në bazë të deklaratës së të dëmtuarës dhe vet të dyshuarve, B... ka folur me telefon me B... dhe e ka aranzhua shfrytëzimin seksual të viktimës në këmbim të pagesës me H..., edhe atë theksoj faktin se B... ka biseduar me B...., ndërsa B.... e ka sjellë viktimën te lokali "A...", në fshatin D...., aty ku ka qenë duke punuar B.... dhe H...., dhe këta e kanë marrë nga aty dhe shkruar në fshatin D... në

motelin “A...”, dhe aty është shfrytëzuar viktimë prej H.B. Unë e kam marr deklaraten e B..., ndërsa kolegët e mi e kanë marrë deklaraten e viktimës dhe të dyshuarve tjerë.

Në pyetjen e përfaqësuesit të ZMNV-së, dëshmitari deklaroi: lidhur me rastin në fjalë, ne jemi informuar prej burimeve tona, e jo nga viktimë.

Në pyetjet e av. Jeton Ibrahim, dëshmitari deklaroi: B... gjatë dhënies së deklaratës në polici, e ka pranuar fajësinë dhe në një moment pasi që është konsultuar me mbrojtësin e tij, deklaratën e ka ndryshuar. Unë deklarova edhe më parë se në fillim B... e ka pranuar fajësinë, por në momentin kur është konsultuar me mbrojtësin e tij, i njëjti e ka ndryshuar deklaratën, kjo është edhe e drejtë e tij, mbrojtësi i tij ka qenë prezentë në momentin kur ka dhënë deklaratë. Jam shumë i sigurt se para se me fillua marrja në pyetje e të dyshuarve, mbrojtësit e tyre kanë qenë të pranishëm të gjithë, sepse unë vet i kam parë se kanë qenë prezentë mbrojtësit e tyre. Deklarimin tim e bazoj se B... ka qenë ndërmjetësues, pasi që ky e ka bërë komunikimin me telefon me B... dhe H.B, e pastaj ka rezultuar kontakti fizik në mes tyre, duke e përfshirë edhe viktimën, në përfundimin si hetues e kemi nxjerr duke u bazuar nga deklaratat e të dyshuarve që kanë kontaktuar në mes veti. Po deklaroj edhe një herë se B... ka qenë në kontakt me viktimën pasi që të njëjtin e ka njohur dhe në bazë të deklaratës atë e ka pasur në kontroll, gjëja se viktimë i ka pasur borxh B... dhe shfrytëzimi i saj nga të tjerët është bërë me qëllim të shlyerjes së borxhit, kështu që B... ka qenë në kontakt me B..., ndërsa H e ka pasur shëf-pronar dhe me fjalë tjera B... e ka thirr B... me prur viktimën me pas marrëdhënie seksuale me të. Për neve si hetues, një herë janë dhënë paratë, atëherë kur viktimë është shfrytëzua seksualisht në hotelin “A”, në fshatin D, dhe nëse nuk gaboj se shumë e të hollave është e saktë ashtu si në kallëzim penal.

Në pyetjen e të akuzuarit B.A, dëshmitari deklaroi: fillimisht kur ke dhënë deklaratë në polici ka pasur mundësi që të jeni në cilësinë e dëshmitarit, por në ndërkohë është dyshuar se ju jeni në cilësinë e të dyshuarit dhe nga ajo kohë të është caktuar mbrojtësi. Unë mendoj se deklaratat e juaja është ashtu siç keni deklaruar dhe është absurde dikujt ti ndryshohet deklaratat.

Në pyetjen e anëtarëve të trupit gjykues, dëshmitari deklaroi: unë dy të akuzuarit edhe atë B.H dhe B.A, më herët nuk i kam njohur dhe se nuk më kujtohet se të njëjtit të kenë pasur ndonjë rast në njësitin ku unë punoj. Unë personalisht nuk e kam intervistuar të dëmtuarën A, por e njëjta është intervistuar nga një kolege në prezencën e përfaqësuesit të mbrojtës së viktimave. Rasti saktësisht nuk më kujtohet, por është shënuar në kallëzimin penal.

Unë siç deklarova edhe më parë se, B së bashku me H dhe viktimën kanë shkuar në hotel “A”, dhe që me veti e kanë pasur edhe viktimën, dhe në këtë rast H.. e ka shfrytëzuar, përkatësisht ka pasur marrëdhënie seksuale me viktimën, edhe atë sa më kujtohet një shumë të parave ja kanë dhënë viktimës për aktin e marrëdhënies, megjithatë shumë nuk më kujtohet, por ekziston në kallëzim penal, e në bazë të komunikimeve në mes vete, unë theksova se viktimë i ka pasur borxh B dhe për këtë qëllim është shfrytëzuar. B gjatë deklaratës së tij nuk e ka pranuar këtë fakt që kinse në emër të borxhit që ia ka pasur viktimë, për shfrytëzim seksual nga ana e Bt dhe H.. që në një mënyrë të shfrytëzohet nga të njëjtit me qëllim që borxhi ti kthehet B. Sipas mendimit tim, ky borxh ka rrjedh për faktin se B ka qenë taksist dhe viktimës i ka shërbyer si taksist dhe mendoj se kjo ka qenë arsyeja. Në fund mund të deklaroj se në bazë të deklaratave si të viktimës, por edhe të dyshuarve, e konkretisht edhe nga veprimet e B.Ht, unë mendoj se i njëjti e ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet.

Në pyetjen e serishme të av. Jeton Ibrahim, dëshmitari deklaroi: sipas meje veprimet e B janë, se i njëjti ka kontaktuar me Bn, e ka marr viktimiten dhe të njëjtën e ka transportuar në fshatin D të "A", ka komunikua dhe ka bërë marrëveshje dhe saktë e ka dërguar aty sipas marrëveshjes me Bn.

3.Mbrojta e të akuzuarve

Në pyetjet e mbrojtësit, av. Masar Morina, i akuzuari B.Adeklaroi: Unë fajësinë e kam pranuar në fazën parapenale, për faktin se kisha presion së pari në paraburgim, për faktin se unë isha i martuar, fëmijët i kisha në shtëpi dhe doja vetëm të dilja nga aty, edhe atë po ashtu kam besuar se pranimi i fajësisë do të më ndihmojë- lehtësojë dënimin, por kjo nuk ka ndodhur, edhe pse kjo ka qenë hera e parë. Edhe këtu në gjykatë është e vërtetë se e kam pranuar fajësinë, por më pastaj jam penduar menjëherë. Më kujtohet plotësisht deklarata të cilën e kam dhënë në prokurori, andaj mbetem në tërësi pranë të njëjtës. Unë në atë kohë punoja përkohësisht në restorant "D", në rrugën e M, ishte Ramazan, fundi i muajit Prill të 2021, dhe udhëtoja me B gjithnjë për në punë. Atë ditë B ka qenë i zënë me pasagjer, dhe më tha nëse do të dërgoj te një tjetër taxi apo të vij unë nëse nuk të pengon prezenca e një pasagjeri tjetër. Unë i thash atij si të duash, por mos u vono se më fillon puna. B brenda dy minutash ka ardhur, dhe kam hipur në taxi mbrapa, ndërsa A ka qenë e ulur në ulësen e përparme. Derisa kemi shkuar te puna ime, A e ka mbajtur tërë kohën kokën mbrapa kah unë, gjëja se unë i kam pëlqyer, dhe ka insistuar te B të na njoftojë. Unë e kam paguar pjesën time prej një euro e gjysmë për shërbimin e taxit, dhe të nesërmen kemi pirë kafe me A, e që këtë takim e kishte caktuar B, me insistimin e A. Po të njëjtën ditë, edhe atë ka qenë siç deklarova më parë fundi i muajit Prill 2021, por data nuk më kujtohet, ka qenë ora policore, dhe kemi qëndruar me A tek motel "D", aty ku punoj në restorant, ku ka pasur edhe dhoma edhe lart. Pak pas orës 21:00, kanë ardhur policia speciale, dhe e kam dërguar A lart në dhomë, që të mos ketë probleme, dhe të mendojnë se është punëtore, dhe i thash më prit derisa të vij unë dhe të shkojnë policia. Pasi që kanë shkuar policia, unë kam shkuar lart, ashtu spontanisht kemi pasur marrëdhënie me dëshirë, as nuk më ka kërkuar para, e as nuk i kam dhënë. E kam thirr B, e ka marrë A së pari, e ka dërguar në shtëpi dhe unë ia kam bërë pagesën e shpenzimeve për taxi, edhe atë dy euro, ndërsa unë mbeta në lokal, e më pas me pronarin kam shkuar në shtëpi. Pas këtij momenti e deri në ditën kritike kur kemi shkuar në restorantin "A" në D, unë nuk jam takuar me A, e as që kam pasur marrëdhënie, ashtu siç deklarova kam pasur vetëm njëherë marrëdhënie seksuale me të. Nga momenti i parë e deri te rasti i dytë në fshatin D mua nuk më ka ndodhur që t'i jap para A.

Unë edhe herën e parë kur kam pasur marrëdhënie seksuale nuk ka kërkuar para e as nuk i kam dhënë. Ditën kur kemi shkuar në fshatin D ka qenë më shumë iniciativa e A, kam marrë një telefonatë prej saj, e që në atë kohë unë punoja në D, në lokalin "A", kur edhe ka ndodhur rasti ditën kritike, kështu që e kam marrë një telefonatë prej A dhe e njëjta mi ka kërkuar 25 euro, ngase ia kishte pasur borxh B. Pastaj unë bisedova me B dhe e pyeta se a është e vërtetë, dhe ai më tha po është e vërtetë dhe se nëse nuk i dorëzoj paratë deri në fund të ditës mund ta humb punën, unë i thash të dyve A dhe B se nuk kam, por nëse punoj diçka, do ta ia bëj zgjidhjen. Unë ia bëra zgjidhjen, konkretisht paratë ia kam kërkuar pronarit të lokalit, atij ia kam kërkuar 30 euro, dhe i thash atij më i ndalë çdo natë nga 10 euro, se po duhet me ia dhënë një shokut tim, sepse ai e ka një hall- zor. Kështu që unë e thirra B, i thash se i sigurova paratë, pak për ty që të kam shok, edhe pak për A se mu dhimb, se ajo filloi të qante. Më pas kanë ardhur të dytë edhe atë B me A. Unë ia kam dhënë B 31 euro, edhe atë 25 euro për borxhin që ia kishte A atij, dhe 6 euro për shërbimet e taxit, po ashtu i ftova me pi edhe nga një pije, por pasi që ishte fundi i orarit të punës, dhe ishin vetëm disa kolegë dhe pronari, A deshi të qëndrojë aty me

neve, por B i tha se nuk të pres dhe kam me i dorëzuar paratë, por unë i premtova B dhe A se do ta dërgoj atë në shtëpi. Kemi qëndruar pak, edhe me plan jemi nisur në fshatin K Atje ka qenë një vend-lokal ku ka punuar në kohën e panDisë, atje kemi shkuar unë, H... dhe A. Ne jemi nisur për në fshatin K, por gjatë rrugës jemi kthyer në motelin "A", në fshatin D, edhe atë në këtë motel jemi kthyer me insistimin e H... Kemi hyrë brenda dhe aty ka qenë prezent vetëm pronari dhe një punëtoare. Kemi pirë pije, A ka qenë e ulur afër Hajrës, dhe pas ca kohe kanë shkuar lart në dhomë, edhe atë me insistimin e H., nuk jemi vonuar shumë dhe erdhi koha me u kthye në shtëpi. Gjatë rrugës për në shtëpi kemi qenë mirë, disponimi mirë, e kam pyet A ku me të dërgua, e njëjta më ka thënë afër "B.M", në lagjen Dh.B. A mi ka kërkuar 20 euro për fëmijët, edhe pse kjo ka deklaruar se unë ia kam dhënë, por e vërteta është se unë nuk kam pasur para me ia dhënë. Por H... a ia ka dhënë apo jo, unë nuk e di. Kështu që më tutje nuk kam dëshiruar që të vazhdoj me të. Shumën e parave prej 25 euro, të cilën ia kam dhënë A në emër të borxhit që ia kishte pasur B, ajo më ka thënë se do t'i kthej, por nuk m'i ka kthyer. Unë për faktin që kam pasur marrëdhënie seksuale nuk i kam dhënë para A, e as që më ka kërkuar. Të nesërmen pas rastit të Dit, A ma ka dërguar një SMS edhe atë në mëngjes, ku shkruante: "Duhesh me mi dhanë qato 20 euro se nuk kam, ose kam me ta gjetur gruan dhe kam me të nda prej saj, dhe kam me i treguar se ne kemi pasur punë". Atë SMS fatkeqësisht ma ka lexuar gruaja e para, dhe gruaja nuk më ka treguar fare, dhe ka shkuar prej kabinës së postës e ka thirrur A. Gruaja iu ka prezantuar si një mërgimtare kinse po dua me të ndihmuar, vetëm më trego se ku banon, krejt kjo që ta kuptojë gruaja se kush është A dhe ku banon. Të njëjtat janë takuar, në pika të shkurta më ka treguar gruaja se kanë pasur mosmarrëveshje me fjalë. Unë nuk e di se kush ka qenë iniciues i rastit.

Në pyetjet e av. Jeton Ibrahim, i akuzuari B. Adeklaro: është e vërtetë se me A jemi takuar 3-4 herë, por marrëdhënie seksuale kemi pasur vetëm një herë. Deklarata e A lidhur me atë se unë i kam thënë asaj se për çfarë arsye me i dhanë para B, kjo nuk është e vërtetë, sepse ajo e ka shpikur vetë këtë, sepse unë përveç një herë që i kam dhënë para, më shumë nuk i kam dhënë. Mendimi im është se me B ka pasur raporte më të mira shoqërore, dhe kur nuk ka pasur para A për shërbime të taksit, i ka mbetur borxh, kjo është arsyeja se kjo ka udhëtuar vetëm me atë- B. B dy herë e ka pru me taksit A, njëherë në rrugën e M... te restorant "D..", dhe njëherë në fshatin D, tek "A. Për këto dy raste ndoshta është dashtë patjetër A me e pru.

Siç deklarova herën e parë e ka sjellë ai dhe në bazë të tij jemi njoftuar me A, dhe herën e dytë për shkak të borxhit me ia dhënë A paratë B. Unë nuk i kam dhënë para B, në emër të asaj se kam pasur marrëdhënie me A.

Në pyetjen e Prokurorit të Shtetit, i akuzuari B. Adeklaro: A mua më ka thirrur në telefon dhe më ka thënë se a ki 25 euro të mi gjesh me ia dhënë B, se ia kam borxh, edhe atë më ka thënë se duhet patjetër me ia dhënë paratë se ai është i trentë. Mua A nuk më ka treguar se për çka ia ka këtë borxh, por B më ka thënë se A mi ka borxh për shërbime të taksisë. Unë shumë prej 25 euro ia kam dhënë B, më shumë për B se sa për A, sepse B e kam shok, por paratë të cilat ia kam dhënë B, deri tani nuk mi ka kthyer e as që ia kam kërkuar B. Arsyeja se pse ne vendosëm me shkuar nga "A.." në K, ka qenë se atje ka qenë pa kufizim të orës policore, ndërsa këtu vetëm e patëm përfunduar orarin e punës. Unë tregova se edhe përkundër faktit se u nisëm për në fshatin K, ne u ndalëm aty në fshatin D. Natyrisht se rregullat e orës policore kanë vlejte edhe në fshatin D, por gjatë rrugës Hajra e ka thirrur pronarin e atij lokalit dhe i ka thënë se: "a je aty se po vijmë me pi nga një pije". Sipas meje lokali në fshatin D ka pasur leje me punuar 24 orë, por ne kemi qëndruar vetëm gjysmë ore. Ne edhe përkundër faktit se ka qenë orë policore, jemi kthyer. H.B më herët nuk e ka njohur A dhe se në lokalit në D aty janë njoftuar.

Në pyetjen e përfaqësuesit të ZMNV-së, i akuzuari B.A deklaroj: unë herën e parë kur jam takuar në taksì, e aty ku ka qenë edhe A, unë nuk kam kërkuar numër të telefonit të A, por e vërteta është se pasi që B mua më ka dërguar në punë, A nga B ka kërkuar kontakt që të ketë me mua, ashtu që B ma ka marrë mua adresën e Facebookut dhe ia ka dhënë A dhe pastaj kemi komunikuar. A përpos ditës kritike që nuk ka treguar që i ka borxh B ajo më parë nuk ka biseduar me mua. Natën kritike kur A ka ardhur në lokalin në fshatin D, ne e kemi prezantuar tek H.... si shoqen tonë. Unë B ia kam dhënë gjithsej 31 euro, 25 euro në emër të borxhit, dhe 6 euro në emër të shërbimeve të taksit, por po theksoj se para se me ardhur B te lokali në fshatin D, më ka thënë se edhe shpenzimet e taksit më kushtojnë në shumë prej 6 euro. Herëve tjera nuk na ka ndodhë që B me na kërkuar para në emër të borxhit të cilat ia ka pasur borxh A.

Në pyetjen e të dëmtuarës A.H, i akuzuari B.A deklaroj: për herë të parë në lokalin e rrugës së M.... kur kemi shkuar, së pari kemi hyrë në lokal poshtë edhe atë kemi qëndruar shumë pak, e pastaj e kam dërguar në dhomë për shkak të policisë.

Ndërsa këtë pohim të të akuzuarit e dëmtuara e kundërshton për faktin se sipas saj kur kemi shkuar te lokali në fjalë në rrugën e M...., menjëherë kemi hipur lart, e poshtë nuk kemi zbritur fare. Unë me ju kam pasur vetëm njëherë marrëdhënie seksuale, edhe atë në rrugën e M...., tek restorant "D...".

E dëmtuara e kundërshton deklaratën e të akuzuarit duke pohuar se tri herë kemi qenë te lokali "D" te rruga e M, ku edhe kemi pasur marrëdhënie seksuale. Unë me ju pasi që jam takuar herën e parë edhe atë kur keni ardhur së bashku me B, me sa më kujtohet të nesërmen jemi takuar me juve.

E dëmtuara deklaroj se i akuzuari nuk e ka treguar të vërtetën.

Në pyetjet e anëtarëve të trupit gjykues, i akuzuari B.A deklaroj: Te restorant "D" në rrugën e M, unë kam punuar tri netë. Te restoranti "A" në fshatin D kam punuar katër vite. Unë siç deklarova më parë tri netë kam punuar te restorant "D", ndërsa natën e fundit ka ardhur A, dhe kemi pasur marrëdhënie. B taksin e ka të firmës "G.T". Unë te restoranti te fshati D, nuk kam shkuar në dhomë te A. Unë në dhomën e motelit në fshatin D, kam qenë vetëm pasi që A ka krye marrëdhënie seksuale me Hajrën, dhe i kam thënë se a po shkojmë te shtëpia se është ora policore, u bë vonë. Pasi që ia kam dhënë të hollat A, unë pastaj nuk ia kam kërkuar këto para, për arsye se të nesërmen e zbuloi bashkëshortja ime. Është e vërtetë se mua me A me ka njoftuar B, ndërsa unë A e kam njoftuar me H. Është e vërtetë se siç deklarova se B e ka pru A në fshatin D, e pastaj aty qëlloi edhe Hajra. Me fjalë të tjera A unë e kam njoftuar me H. Po unë kam qenë i njoftuar lidhur me statusin e A, ajo më ka thënë se jam e divorcuar dhe i kam dy fëmijë. Unë i kam shoqëruar A dhe H njëherë me qëllim që të shkojmë në fshatin K, e më pastaj në fshatin D, për faktin se unë nuk kam pasur me çka me u kthye. Nuk e kam ditur arsyen pse po shkojmë, por kam menduar se po shkojmë vetëm për nga një kafe. Nuk e kam ditur arsyen e B, se për çka mi ka kërkuar paratë. Unë H.. paratë ia kam marrë me qëllim me ia kthyer, dhe se të njëjtat ia kam kthyer me punë.

Në pyetjet e mbrojtësit, av.Jeton Ibrahim, i akuzuari B.H ka deklaruar: unë në tërësi qëndroj pranë mbrojtjes të cilën e kam dhënë në seancën e kaluar të shqyrtimit gjyqësor. Unë gjatë vitit 2021 kam punuar si taksist te kompania "G.T" në Gj.... Në këtë kompani nuk kam pasur orar të caktuar sepse kam qenë edhe shef i punëtorëve dhe kam pasur të drejtë me e

marrë kerrin edhe te shtëpia. Me të akuzuarin B.A njihem që 15 vite. Edhe me të dëmtuarën njihem diku 7-8 muaj, para se me ndodhë rasti, por megjithatë unë datën e saktë nuk e di se kur ka ndodhur rasti. Unë të dëmtuarën çdo herë e kam respektuar dhe çdo herë kur ka pasur me shkua diku ajo më ka thirr në telefon, qoftë ditën apo natën. Raportet me të njëjtën i kemi pasur shumë të mira, kurrë keq nuk kemi pasur. Ka ndodhur që me më mbet borxh A edhe atë më së shumti 60 apo 65€, atëherë kur të njëjtën e kam dërguar tek familja e saj në Pejë, por shumë prej 60 apo 65 euro në ndërkohë A m'i ka kthyer. Unë derisa e kam pasur A në kerr taxi, në ndërkohë më ka thirr B në telefon, me shkua me e marrë tek stacioni i autobusëve, e unë e kam pasur A në kerr, dhe meqë e kisha në kerr A e kam pyet se a të pengon me shkua me e marrë edhe një udhëtar tjetër, B nuk i ka penguar, e po ashtu edhe A më tha që nuk e pengon. Kemi shkuar dhe e kemi marrë B, dhe e kemi dërguar te puna e tij ku punonte. Të njëjtën kohë këta të dy u pëlqyen dhe i morën numrat e telefonave mes veti. Unë nuk mund ta di saktësisht se cili i pari e ka kërkuar numrin e telefonit. Ndoshta pas dy ditëve A e kam dërguar në lokal ku ka punuar B, te restorant "D", në rrugën e M. Nëse nuk gaboj dy apo tri herë A e kam dërguar te restorant "D" në rrugën e M. Herën e parë kur e kam dërguar A te B, pagesën e ka bërë B. Njëherë e mbaj në mend se B mi ka dhënë 25 euro për borxhin e femrës së vet A, por kjo nuk ka ndodhur në herën e parë, por njëherë tjetër. Unë shumë herë e kam mbuluar borxhin e A për shërbimin që e kam bërë si taksi, edhe atë me qëllim që mos ta humb vendin e punës, por A në ndërkohë ma ka dhënë borxhin, por për një borxh tjetër që ka pasur me mi dhënë në shumë prej 25 euro, A është marrë vesh me Bn që B të ma jep borxhin e A. Unë ndoshta kam mundur me i bo presion A me ma kthyer borxhin, për shkak se unë kam mundur me e humb punën, e pastaj A ia ka kërkuar Bt. Besi më ka thirr në telefon dhe më ka thënë nuk kam tash, por më vonë ndoshta mundem me i marrë te puna.

Dhe kjo ditë ka qenë atëherë kur më ka thirr A me e dërguar në vendin ku ka punuar B. Borxhin ka pasur me ma la A, ndërsa Besi ia ka paguar shërbimet e taksit në shumë prej 6 euro A. Unë nuk kam pasur kurrfarë marrëveshje as me B e as me H. Më ka ndodhur edhe raste të tjera kur unë i kam shërbyer si taksi edhe familjes së B. Unë përpos veprimtarisë si taksi që kam punuar e kemi edhe lokal "B.Sh.G". A ka pasur mundësi të shkoj edhe me taksistë tjerë. Unë A asnjëherë në jetë nuk e kam dërguar për t'i mundësuar shërbime seksuale me dikë tjetër, e as me të akuzuarin.

Në pyetjen e Prokurorit të Shtetit, i akuzuari B.H deklaroi: unë me sa di A përpos Bt shok tjetër nuk ka pasur. Mua më ka ndodhur edhe herëve tjera që ta dërgoj A në ndonjë vend dhe ta pres pesë orë, por unë asnjëherë nuk e kam pyetur pse po vonohesh kaq shumë, mua kë ka interesuar vetëm fitimi. Kështu që dërgimi i saj deri në Prishtinë ka qenë 20 euro, dhe 4 euro ora. Ka ndodhur edhe në Gjilan që e kam pritur nëpër markete dhe e kam pritur derisa ka kryer punë, por taksi metrin e kam pasur ndezur. Unë nuk besoj që herëve tjera të ketë ndodhur që B t'ia paguaj borxhin që ia ka pasur A ndokujt tjetër.

Në pyetjen e përfaqësuesit të ZMNV-së, i akuzuari B.H deklaroi: unë siç deklarova edhe më parë, përpos njëherë që e kam dërguar A, e që në veturë që ka qenë edhe B, të njëjtën edhe dy herë tjera e kam dërguar te lokali ku punonte Besi, por nuk ma ka marrë mendja se po shkon me u takuar me B.

Në pyetjet e anëtarëve të trupit gjykues, i akuzuari B.H deklaroi: ne gjatë kohës sa unë kam punuar në kompaninë "G.T", barazimin çdo ditë e kemi bërë. Për borxhin të cilin nuk ka mundur A të ma kthej me kohë, unë i kam dhënë nga paratë e mia, e pastaj A m'i ka kthyer. Unë ndoshta brenda javës e kam dërguar A te Besi, në lokal "te D" në rrugën e M, pastaj e kam dërguar edhe te restorant "A" në fshatin D. Kur e kam dërguar A te restorant "A", ajo ka

hyrë brenda me pi pije, e ndoshta më ka thirr edhe mua, por unë nuk kam hyrë se është dashur me pagua vet. Së pari A mua më ka thirr për me dërgua te lokali “A” në fshatin D, dhe se 6 euro i kushtoi asaj shërbimi i taksisë, por A më ka thënë se e paguan Besi atje, kurse unë asaj i kam thënë se pa dalë Besi nuk guxon me dalë nga kerri. Ditën kritike kur e kam dërguar A, nëse nuk gaboj A me ka thirr që ta dërgoj. Unë qëllimin e kam pasur vetëm ta dërgon A te lokali “A” në D, kur doli A prej kerrit, erdhi Besi më tha hajde bir pije një, dhe në atë moment mi ka dhënë 6 euro për shërbim të taksit dhe 19 euro për borxh, gjithsej 25 euro. E vërteta sipas meje është se Besi mi ka dhënë 25 euro, edhe atë sipas marrëveshjes që kur të mi jep A mua, unë me ia dhënë Besit, por unë këto para deri më tani nuk ia kam dhënë Besit. Unë nuk ia kam dhënë paratë Besit, sepse deri më tani A nuk mi ka kthyer mua, e as Besi nuk mi ka lypë. Unë e di saktësisht se A te restorant “D” e kam dërguar dy herë, ku herën e parë ka qenë kur janë njoftuar, herën e dytë po ashtu te restorant “D” dhe herën e tretë te restorant “A” në fshatin D. Unë nuk e kam ditur statusin e saj e as gjendjen ekonomike të A, sepse ajo shumë herë ka pasur para në duar. Unë e kam ditur se A është në lidhje me Besin. Unë i kam marrë 6 euro në emër të shërbimit të taksit dhe 19 euro në emër të borxhit, sepse ky-Besi e lajti borxhin e femrës së vet. Nuk është e vërtetë se Besi mi ka dhënë mua 31 euro. Unë çdo herë kur ka kërkuar A me e dërguar te Besi, e kam dërguar, ngase e kam ditur se kanë qenë në lidhje. Me sa më kujtohet mua, besim më ka thënë se a mund të ma gjesh numrin e telefonit të A.

Ka mundësi që numrin e telefonit të A të ma ketë kërkuar Besi, por vetëm me pëlqimin e A. Unë përpos që e di që A ka mbetur në restorant “A” në D, nuk e di se çka ka ndodhur me të.

4.Fjala përfundimtare e palëve

Prokurori i Shtetit, Isuf Sadiku ka deklaruar: mbetëm në tërësi pranë fjalës përfundimtare të dhënë me 06.04.2022, sa i përket të akuzuarve B.H dhe B.A, përkitazi me dispozitivin I të aktit akuzues, për më tepër shtuar edhe aktgjykimin e mëparshëm të kësaj gjykate përkitazi me të akuzuarin H.B, ngase sipas dispozitivit II të aktakuzës i njëjti është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit me numër PAKR.nr.292/2022 të datës 20.07.2022, e që i akuzuari H.B është dënuar për shkak të veprës penale, shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit nga neni 228 paragrafi 1 i KPRK-së, e që kjo vepër penale ka rrjedh si pasojë e veprës penale të kryer nga të akuzuarit B.H dhe B.A, të përshkruar si në dispozitivin I të aktakuzës lëndore, trafikimi i qenieve njerëzore nga neni 165 paragrafi 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, andaj i propozojmë gjykatës që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen komfor dispozitave të KPRK-së, ashtu që me rastin e matjes së dënimit përveç fakteve të propozuara në fjalën përfundimtare i propozojmë gjykatës që të ketë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale së të akuzuarve, si dhe intensitetin e lartë të rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale.

Përfaqësuesi i ZMNV-së Egzon Maloku ka deklaruar: e mbështesim në tërësi fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit, ndërsa në emër të të dëmtuarës paraqesim kërkesën pasurore-juridike.

Mbrojtësi i të pandehurit B.H, avokati Jeton Ibrahimimi ka deklaruar: lidhur me pretendimet e Prokurorisë Themelore në Gjilan, pa mëdyshje nuk vërtetohet as edhe një provë apo dëshmi e vetme se i mbrojturi im B.H ta ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Sipas pretendimeve të mbrojtjes së të akuzuarit në fjalë, nuk duhet të falur besimi deklaratës së të dëmtuarës në cilësi të dëshmitares A.H, sepse ajo vetëm e ka trilluar ngjarjen, përkatësisht ka theksuar se vet B ma ka konfirmuar duke thënë se unë çdo herë që kryer marrëdhënie seksuale me ty, duhet që ta paguajë B, por në anën tjetër ka deklaruar se unë nuk e di se pse B i ka dhënë para B, por në anën tjetër sipas saj vet B më ka pyetur se pse unë duhet me i dhënë para B, ndërsa i akuzuari B.Anë deklaratën e tij të dhënë para trupit gjykues me datë 06.12.2022 ka

deklaruar: “Unë nuk i kam dhënë para B në emër të asaj se kam pasur marrëdhënie seksuale me A”, e që sipas mbrojtjes i bie që të hollat që janë dhënë të akuzuarit B.H janë bërë në emër të shërbimeve taksi, e jo ashtu siç pretendon organi i akuzës dhe viktimja. Me fjalë të tjera, mbrojtësi në fjalën përfundimtare ka theksuar se duhet që ti falet besimi deklaratës së të akuzuarit B.Ae jo të dëmtuarës. E po ashtu sipas mbrojtjes nuk duhet ti falet besimi as deklaratës së dëshmitarit- hetuesit S.Z, i cili gjatë dëshmisë së tij ka deklaruar “se duke u bazuar në deklaratën e të dëmtuarës dhe vet të dyshuarve, shihet se B ka folur me telefon me B dhe e kanë aranzhua shfrytëzimin seksual në këmbim të pagesës me H”, e që për mbrojtjen kjo deklaratë paraqet vetëm një supozim dhe assesi e faktuar me prova. Në fund sipas mbrojtjes meqenëse aktakuza nuk ka mbështetje në asnjë provë relevante dhe se e njëjta është mbështetur vetëm në deklaratën e të dëmtuarës A.H, e që po të shikohet sipas mbrojtjes deklaratat e saja janë kontradiktore me njëra tjetrën dhe të paqëndrueshme.

Andaj, mbrojtja konsideron se gjykata nuk do ta shpall fajtor të mbrojturin tim B.H, duke u mbështetur vetëm në një deklaratë, apo duke i dhënë një rëndësi vendimtare deklaratës së të dëmtuarës apo të përdoret si provë e vetme vendimtare fajësuese. Në fund mbrojtja i propozon gjykatës që në mungesë të provave në pajtim me nenin 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPPRK-së, të mbrojturin tim ta lirojë nga akuza për veprën penale dispozitivi I i aktakuzës, PP.I.nr.178/2021 të datës 12.11.2021, pasi që me këto prova dhe dëshmi nuk mundet që të vërtetohet fajësia e të mbrojturit tim.

I akuzuari B.H ka deklaruar: e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të avokatit dhe se nuk kam çka të shtoj.

Mbrojtësi i të pandehurit B.A, avokati Masar Morina ka deklaruar: Pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore në këtë gjykatë nuk është vërtetuar baza e aktakuzës sa i përket të mbrojturit tim B.A, ta ketë kryer veprën penale në bashkëveprim, trafikim me njerëz nga neni 165 paragrafi 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTHDKR, PP.I.nr.178/2021 të datës 12.11.2021. Nëse e vlerësojmë deklaratën e të mbrojturit tim B.A, vijmë deri te konkludimi se nuk është kontestuese se i njëjti me të dëmtuarën A.H ka pasur marrëdhënie seksuale, e po ashtu nuk është kontestuese se me rastin e dërgimit të së njëjtës me taksi i janë paguar vetëm shërbimet e taksistit e jo edhe diçka tjetër. Po ashtu nuk ka qenë kontestues fakti se e dëmtuara në fjalë i kishte pasur borxh taksistit, e në rastin konkret bëhet fjalë për B.Hn, por edhe nga vet deklarata e dëshmitares thuhet se B ta ketë paguar borxhin për të dëmtuarën në emër të B si dhe shpenzimet e taksistit, me rastin e dërgimit të të dëmtuarës në vendin e punës ku ishte duke punuar B.A. Në vazhdim mbrojtja ka theksuar se meqë marrëdhënia seksuale në mes të dëmtuarës në fjalë dhe të B.At kanë qenë me pëlqimin e të dyve, kjo nënkupton vet vetiu se nuk kemi të bëjmë fare me veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza Bn. Andaj, meqë nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme se i akuzuari ta ketë kryer veprën penale nga dispozitivi I i aktakuzës lëndore, kërkojmë nga gjykata që të njëjtin ta lirojë nga aktakuza sepse nuk është provuar se i mbrojturi im ta ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari B.Aka deklaruar: e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të avokatit dhe se nuk kam çfarë të shtoj.

5. Konstatimet dhe vërtetimi i gjendjes faktike

Gjykata pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të cekura si më lartë gjeti se: të akuzuarit B.H dhe B.A, në kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin I të aktakuzës lëndore, në bashkëveprim kanë kryer veprën penale, trafikimi me njerëz nga neni 165 paragrafi 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Se të akuzuarit e sipër theksuar, kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, është vërtetuar edhe nga deklaratat e të dëmtuarës në cilësi të dëshmitares A.H, e cila e ka përshkruar gjendjen faktike se si ka rrjedhur ngjarja nga momenti i takimit të parë me të akuzuarin B.A, e që sipas dëshmitares njoftimi me të akuzuarin B.. e ka ndërmjetësuar i akuzuari B.H, edhe atë gjatë transportimit me taksì, i akuzuari B.. e kishte pyetur paraprakisht të dëmtuarën-dëshmitaren A, se a të pengon që unë të marr një pasagjer tjetër, i cili po kërkon me dërguar te vendi i tij i punës, për të cilën e dëmtuara-dëshmitarja ishte pajtuar, e që bëhet fjalë për të akuzuarin B..

Kështu që të nesërmen përmes B, A ishte takuar me Bn dhe kishin vazhduar lidhje dashurie. Pasi që A dhe B ishin pëlqyer mes veti, natyrisht se ata kishin vazhduar edhe të takohen fizikisht, herën e parë te lokali ku punonte i akuzuari B.., në fshatin M.., përkatësisht në lokalin "D", ku edhe kishin pasur marrëdhënie seksuale me pëlqimin e të dyve, e që sipas të dëmtuarës-dëshmitares edhe dy hera të tjera, atë me taksì B e kishte dërguar te B, aty ku edhe punonte, e po ashtu sipas të dëmtuarës-dëshmitares kishin pasur marrëdhënie seksuale, ndërsa shpenzimet rreth shërbimit të taksit, sipas të njëjtës B ia kishte bërë B në shumat prej 30-40 Euro.

Për gjykatën nuk ka qenë kontestues fakti se e dëmtuara-dëshmitarja në fjalë, është njoftuar përmes B.Ht, sepse këtë fakt e ka pohuar edhe vet i akuzuari B.., ngase ditën e parë kur ishin takuar, gjatë udhëtimit me taksì, sipas të akuzuarit B.., thuhej se nuk i kishin shkëmbyer - ndërruar numrat e telefonit me të dëmtuarën A.., mirëpo të nesërmen përmes B dhe me insistimin e A jemi takuar dhe kemi pirë kafe, prandaj gjykata nuk ia fali besimin deklaratës së të akuzuarit B.H, se të njëjtit i kanë shkëmbyer numrat e telefonit, me arsyetimin se ata janë pëlqyer.

Po ashtu gjykata nuk ia fali besimin as deklaratës së të akuzuarit B.., se me të dëmtuarën-dëshmitaren ka pasur marrëdhënie seksuale vetëm një herë, në motelin "D", për shkak se përpos të dëmtuarës- dëshmitares e cila gjatë deklaratës së saj ka pohuar se në të njëjtin lokal kishin pasur 2-3 herë marrëdhënie seksuale, e që ky fakt është vërtetuar edhe nga deklaratat e vet të akuzuarit B.., sepse vet i akuzuari B.. në mbrojtjen e tij dhe në pyetjet e parashkuara ka deklaruar se A e ka dërguar tek i akuzuari B.. 2-3 herë në lokalin "D", në rrugën e M, duke deklaruar se nga i njëjti i ka marrë vetëm të hollat për shërbimet e taksistit, e jo edhe paratë të cilët kinse i akuzuari B.. ia kishte dhënë në emër të shërbimit - gjegjësisht të kryerjes së marrëdhënies seksuale me të dëmtuarën.

Gjykata po ashtu nuk ia fali besimin as deklaratës së të dëmtuarës- dëshmitares A.H, gjëja se edhe për këto 2-3 hera që B t' ia kishte dhënë 30-40 Euro para B, sepse këtë fakt gjykata nuk mundi ta vërtetoj me asnjë provë tjetër, edhe pse e dëmtuara në fjalë gjatë deklaratës së saj ka pohuar disa herë se unë vet e kam parë që B pas çdo marrëdhënie seksuale që kem pas me të, kur ka ardhur me më marr B me taksì, t' ia ketë dhënë 30-40 Euro. Për gjykatën edhe ky fakt nuk ka qenë bindës, pasi që e dëmtuara deklaronte se e kam parë duke ia dhënë 30 e herë 40 Euro, por pa qenë e sigurt në pohimin e saj, në anën tjetër po ashtu e dëmtuara- dëshmitarja pohonte se në kuadër të kësaj shume, të akuzuarit B.., B i ka dhënë para në emër të shpenzimeve të transportimit të saj me taksì. Prandaj, meqë gjykata këtë fakt nuk mund që ta vërtetoj saktësisht, sepse edhe vet e dëmtuara në deklaratën e saj nuk ishte e sigurt, andaj, edhe nuk ia fali besimin.

Se të akuzuarit kanë kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitivin I të aktakuzës, nuk ka qenë fare kontestues fakti, sepse edhe e dëmtuara- dëshmitarja e sipër theksuar, po ashtu edhe

të akuzuarit e sipër theksuar, e kanë pranuar faktin se para se të shkoj e dëmtuara- dëshmitarja A.. te lokali “A” në fshatin D, ku ishte duke punuar i akuzuarit B., paraprakisht vet e dëmtuara kishte komunikuar me Bn, duke i thënë se a ke mundësi me mi gjet 25 euro, me ia dhënë B në emër të borxhit, duke e bindur Bn se patjetër duhet me ia sigurua paratë B, sepse ai është i trentë. Për këtë çështje, gjegjësisht lidhur me këto para, pastaj kishin biseduar edhe të akuzuarit ndërmjet veti me telefon, e që në fillim B i kishte thënë B se për momentin nuk kam para, por po shikoj në ndërkohë mos po të bëjë zgjidhje. Pasi që B kishte kërkuar nga pronari i lokalit, gjegjësisht H.B, ku ishte duke punuar, në lokalin në fjalë “A”, duke i thënë se a ki mundësi me mi dhënë 30 Euro, dhe se nga 10 Euro, për çdo natë ti kthej, duke u arsyetuar se këto para duhet me ia dhënë shokut tim, i cili e ka një hall-zor.

Meqë H.B- pronar i lokalit, ia kishte gjetur të hollat Bt, atëherë B e kishte ftuar me telefon B dhe i kishte thënë se të sigurova paratë, pak për ty që të kom shok, edhe pak për A se mu dhimbtë, pastaj B së bashku me A kanë shkuar te vendi i punës, gjegjësisht te lokali “A”, në fshatin D, dhe ia ka dhënë 31 Euro, edhe atë: 25 euro për borxhin, të cilin e kishte A atij, dhe 6 Euro për shërbimet e taksit, ndërsa sipas të akuzuarit B., meqenëse A dëshironte të qëndronte me neve në lokal, ajo ka vazhduar së bashku me mua dhe H.B., B është kthyer, e që sipas tij kishte me i dorëzua paratë, pastaj unë i premtova B dhe A se pasi ta përfundojmë ndejën, A do të dërgojmë në shtëpi.

Kështu që gjendja faktike është vërtetuar mjaftueshëm edhe sa i përket shumës së parave prej 31 Euro, të cilat B ia kishte dhënë B, sepse këtë fakt nuk e ka kontestuar as e dëmtuara- dëshmitarja A., si dhe të akuzuarit e sipër theksuar, edhe pse të njëjtit gjatë mbrojtjes së tyre, janë arsyetuar duke thënë se 6 Euro ia dhënë B për shërbimet e transportimit me taksi, me rastin e dërgimit të A në lokalin “A” në fshatin D, ndërsa, sa i përket shumës tjetër prej 25 euro, sipas të akuzuarve, po një ashtu edhe nga vet e dëmtuara- dëshmitarja, gjëja se kjo pjesë e parave i është dhënë B në emër të borxhit. Se shumën e parave të cilën B ia kishte dhënë B, nuk ishte dhënë në emër të borxhit për faktin se këto para, që nga atëherë, por edhe tani nuk janë kthyer të akuzuarit B., e as H.B., sepse natën kritike, pasi që iu ishin dhënë paratë B, B.Adhe H.B nga fshati D, kishin vazhduar rrugën për në fshatin K, dhe me të arritur në fshatin D, përkatësisht në motelin “A”, ku me insistimin e H.B.. ishin ndalur aty, e pas një kohe H.B së bashku me të dëmtuarën A.H kishin pasur marrëdhënie seksuale në një nga dhomat e lokalit në fjalë. Siç shihet edhe nga deklaratë e vet të dëmtuarës e gjithë ngjarja e zhvilluar ndërmjet asaj, si dhe të akuzuarve ishte bërë me marrëveshje paraprake, sepse B, B dhe A paraprakisht kishin komunikuar ndërmjet veti, ishin dakorduar që B t’ ia japin 31 Euro, sipas tyre në emër të një borxhi, të cilën ia kishte pasur A B, ndërsa në anën tjetër B pa dëshirën e A, e kishin dërguar atë në motelin “A”, në fshatin Dë, e natyrisht pa dëshirën e saj H.B, kishte pasur marrëdhënie seksuale me të njëjtën.

Se i akuzuari H.B e kishte kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitivin II të aktakuzës lëndore, është vërtetuar edhe me aktgjykimin e shkallës së parë të kësaj gjykate PKR.nr.187/2021 të datës 22.04.2022, përmes të së cilës H.B për veprën penale, shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit nga neni 228 paragrafi 1 të KPRK-së, është shpallur fajtor, dhe është gjykuar në pajtim me dispozitat e Kodit Penal, dhe se i njëjti me aktgjykimin të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.292/2022, të datës 20.07.2022, sa i përket të akuzuarit H.B për veprën penale, me të cilën e ka ngarkuar aktakuza lëndore, aktgjykimi i Gjykatën Themelore në Gjilan- Departamenti për Krime të Rënda, me numër dhe datë të shënuar si më lart është vërtetuar, ndërsa, për të akuzuarit B.H dhe B.A, çështja penale për dispozitivin I të aktakuzës lëndore është kthyer në rigjykim.

Se të akuzuarit B.H dhe B.A kanë kryer veprën penale, të përshkruar si në dispozitivin I të aktakuzës lëndore, është vërtetuar mjaftueshëm edhe për faktin se i akuzuari B.H para 7-8 muajve, e kishte njohur të dëmtuarën – dëshmitaren A.H, për shkak se gjatë tërë kohës të njëjtës i kishte ofruar shërbimet e transportimit me taksë, pothuajse çdo herë kur e dëmtuara në fjalë kishte pasur për të udhëtuar, ka udhëzuar me të njëjtin.

Po ashtu i akuzuari e kishte ditur gjendjen e vështirë ekonomike të saj, ishte njoftuar se e dëmtuara ishte e divorcuar, e papunësuar, dhe jetonte me dy fëmijë të mitur, pra me fjalë të tjera ky i akuzuar meqë e ka ditur statusin e saj ekonomik-social, nuk është dashur në asnjë mënyrë që të ndërmjetësoj, përkatësisht ta njoftoj së pari me të akuzuarin B.A, e pastaj B të njëjtën e ka vur në kontakt dhe lidhje pa dëshirën e saj me të akuzuarin H.B.

Edhe nga deklarata e dëshmitarit S.Z, gjykata erdhi në përfundim se i akuzuari B.H kishte kryer veprën penale të përshkruar si në dispozitivin I të aktakuzës lëndore, sepse vet e dëmtuara- viktima kishte deklaruar që me B kishte pasur shoqëri, por gjatë kohës sa e ka bartur me taksë, B të njëjtës i ka siguruar klientë për me kryer marrëdhënie seksuale, e që në rastin konkret kishte të bëjë me të akuzuarin B.Adhe H.B, dhe se për këtë rast vet e dëmtuara, ka deklaruar se B ka biseduar me të akuzuarin, e pastaj edhe vet viktima ka biseduar me të njëjtit për ofrimin e këtyre shërbimeve, në atë mënyrë që B me i kompensua, me pretekst se gjëja se e dëmtuara i ka pasur borxh B, dhe se me ofrimin e shërbimeve seksuale duhet ti kryhet borxhi B.

Se është kryer vepra penale e trafikimit me njerëz, nga neni 165 paragrafi 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për gjykatën nuk ka qenë aspak kontestues, sepse mbrojtja e këtyre të akuzuarve, gjëja se shuma e parave prej 31 Euro e dhënë nga ana e Bt të akuzuarit B., në emër të borxhit, kinse sipas tyre A ia kishte B, për gjykatën aspak nuk ishte dëshmi bindëse, sepse të akuzuarit në fjalë gjatë mbrojtjes së tyre, këtë fakt e përdornin si alibi, gjegjësisht me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, andaj, edhe mbrojtjes, përkatësisht deklaratave të tyre, në këtë aspekt nuk ia fali besimin, sepse edhe B.H, e pastaj edhe B.Ae kanë ditur gjendjen e vështirë ekonomike dhe sociale, të dëmtuarës në fjalë. Prandaj, nuk është dashur që ta njëjtën ta shfrytëzojnë me qëllim të trafikimit, ashtu siç është përshkruar si në dispozitivin I të aktakuzës.

Nga të lartcekurat gjykata në bazë të nenit 361 paragrafi 1 dhe 2 të KPRK-së, ka vlerësuar secilën provë një nga një, e pastaj edhe në lidhje me provat si tërësi, dhe në bazë të vlerësimit dhe administrimit të të njëjtave, ka ardhur në përfundim se faktet konkrete janë provuar mjaftueshëm andaj, të akuzuarit: B.H dhe B.A janë penalisht përgjegjës dhe fajtorë për veprën penale me të cilat i ngarkon aktakuza lëndore. Andaj, të akuzuarit B.H dhe B.A për veprën penale, trafikimi me njerëz nga neni 165 paragrafi 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i ka shpallur fajtorë dhe i ka gjykuar si në dispozitivin e aktgjykimit.

Në dënimin e shqiptuar me burgim, të akuzuarve B.H, B.Anë kuptim të nenit 79 të KPRK-së, iu llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 14.10.2021 deri në 04.03.2022.

6.Rrethanat të cilat janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e përcaktimit të dënimit për të akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve: 69, 70, 71, 72, 73 dhe 74 të KPRK-së.

Në rastin konkret si rrethanë rënduese për të akuzuarit: B.H dhe B.A, gjykata ka pasur parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, mënyrën, motivin dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale ndaj të dëmtuarës, si dhe shfrytëzimin e gjendjes së vështirë ekonomike - sociale të të dëmtuarës.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata për të akuzuarit B.H dhe B.A nuk gjeti.

7.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale, si dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe qëllimi i dënimit

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve të sipër theksuar, edhe atë duke marrë parasysh rrethanat e përmendura si më lartë, është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale së të akuzuarve, si dhe faktin se me këto sanksione penale do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, e të cilat dënime kanë për qëllim parandalimin e kryerësve nga kryerja e veprave penale për të ardhmen dhe se me këtë dënim do të arrihet në rehabilitimin e tyre, dhe se këto dënime do të kenë efekt preventiv dhe te personat e tjerë në përmbajtjen nga kryerja e veprave penale, dhe se këto dënime do të shprehin gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektim të ligjit.

8.Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Për shpenzimet e procedurës për të akuzuarit, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 452 paragrafi 1 dhe 3 e lidhur me nenin 449 paragrafi 1 dhe 2, nën paragrafi 2.6 të KPPRK-së, ndërsa për taksën në emër të kompensimit të viktimave të krimit, ka vendosur në kuptim të nenit 39 paragrafi 3.2 të Ligjit për kompensimin e Viktimave, nr.05/L-036.

9.Vendimi për kërkesën pasurore juridike

E dëmtuara A.H, në kuptim të nenit 462 të KPRK-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

Nga të cekurat më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN- Departamenti për Krime të Rënda
PKR.Nr.154/2022, më 20.02.2023**

**Zyrtare ligjore
Zahide Rexhepi**

**Kryetari i trupit gjykues
Islam Thaçi**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga data e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2021:231063
Datë: 23.02.2023
Numri i dokumentit: 04006629